



BASHKIA SELENICË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SELENICË
DREJTORIA E BURIMEVE NJEREZORE, NDIHMES LIGJORE DHE MARREDHENIEVE ME
PUBLIKUN

Nr 990 Prot.

Selenicë, më 07.04 .2026

**SHPALLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBBIMIN CIVIL**

Specialist për projektet

Kategoria e pagës IV-3

Lloji i diplomës “Shkenca Inxhinierike” niveli minimal i diplomës “Bachelor”

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, Institucioni Bashkia Selenicë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionet::

Specialist per projektet – Drejtoria e Integritimit Europian dhe Projektimit

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Për të dyja Procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbim civil) aplikohet në të njëjtën kohë!



Afati për dorëzimin e Dokumenteve:


për lëvizjen paralele do të jetë 20.04.2026
për praninë në shërbimin civil 30.04.2026

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Pozicioni kontribuon në forcimin e imazhit institucional të Bashkisë Selenicë dhe në rritjen e besimit të publikut përmes informimit të saktë dhe shërbimit cilësor

Është punonjës civil dhe është në varësi të: Drejtoria e Integritimit Europian dhe Projektimit

- Harton dhe zhvillon projekte për zhvillimin urban, infrastrukturën dhe shërbimet publike.
- Përgatit dokumentacionin teknik dhe administrativ për aplikime në fonde kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Ndjek zbatimin e projekteve nga fillimi deri në përfundim.
- Monitoron afatet, buxhetin dhe cilësinë e punimeve.
- Bashkëpunon me drejtorinë e tjera brenda bashkisë.
- Koordinon me kompani ndërtimi, konsulentë dhe donatorë.
- Organizon takime dhe raporton mbi ecurinë e projekteve.
- Harton raporte periodike mbi progresin e projekteve.
- Analizon nevojat e komunitetit dhe propozon iniciativë të reja.
- Vlerëson ndikimin ekonomik dhe social të projekteve.
- Identifikon mundësi financimi dhe aplikon për grante.
- Menaxhon buxhetin dhe shpenzimet sipas planit financiar.
- Siguron që projektet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Përbush të gjitha detyrat që i ngarkohen nga drejtori, në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- Raportimi tek eprori për detyrat e realizuara;



LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria IV-a);
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;

c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Profesional” (minimalisht) në shkencat inxhinierike
- Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit duhet të jenë të njësura pranë institucionit përgjegjës për njehesimin e diplomave.
- Të ketë të paktën 1 vitë përvojë pune
- Të kenë njohuri të mira kompjuterike.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT



Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 20.04.2026.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 21.04.2026, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkia Selenice ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.


Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni. nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore”;
- Njohuri mbi Ligjin nr.44/2015 “ Kodi i Procedurave Administrative ne Republikën e Shqipërisë
- Njohuri mbi Ligjin nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar,
- Njohuri mbi Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE



Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
- Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Selenicë do të shpallë fituesin në Faqen Zyrtare të Bashkisë, Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike .

2- PRANIM NE SHERBIM CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nepunesit civil”, i ndryshuar.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Profesional” (minimalisht) në Inxhinieri Mjedisi
 - Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit duhet të jenë të njësuar pranë institucionit përgjegjës për njehesimin e diplomave.
- a) Të jetë shtetas shqiptar;
 - b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - c) Të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
 - d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
 - e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
 - f) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013. “Për nepunësin civil”, i ndryshuar..

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);



- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 30.04.2026.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil, do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **01.05.2026**, njëسيا e menaxhimit të burimeve njetëzore të Bashkise Selenicë ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njofohen individualisht nga njëسيا e menaxhimit të burimeve njetëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore datë në zbatim të tij;
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore”;



- d) Njohuri mbi Ligjin nr.44/2015 “ Kodi i Procedurave Administrative ne Republikën e Shqipërisë
- e) Njohuri mbi Ligjin nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar,
- f) Njohuri mbi Vendimin nr. 408. datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimitit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;
- d- Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Selenicë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.



DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Joada Ngucaj